

ALARM 17

IDEOLOGJIZIMI I KUSHTETUTËS

Me 29 shtator 2014, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë, LGBTI Qendra për përkrahje, Qendra maqedonase për arsimim evropian dhe Koalicioni për të drejta seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara dorëzuan vërejtjet propozimet dhe sugjerimet e tyre Qeverisë së RM, që është propozues i amendamenteve kushtetuese XXXIII, XXXIV, XXXV, XXXVI, XXXVII, XXXVIII dhe XXXIX, mbi Propozim amendamentet¹.

Me 17 shtator 2014, organizatat e lartpërmendura zhvilluan një diskutim publik² që ishte i hapur për publikun, ku si folës ishin ftuar persona që ne konsideruam se mundën në mënyrë profesionale, të hapur dhe me kritika konstruktive të japin mendimet e tyre mbi Propozim amendamentet. Kështu që, vërejtjet dhe propozimet e dorëzuara janë rezultat i qëndrimeve tona dhe qëndrimeve profesionale të shprehur nga pjesëmarrësit në diskutimin publik.

Në korrespondencën e tyre, organizatat kanë shprehur vërejtjet e tyre mbi ndryshimet e Kushtetutës. Ajo që veçanërisht na brengos është mungesa e atmosferës demokratike në procesin e ndryshimit të aktit më të lartë ligjor. Si kurrë më parë, këto ndryshime të kushtetutës kryhen me shpejtësi të madhe, këshillime të papërshtatshme me publikun dhe në mungesë të opozitës në Kuvendin e RM.

Veç kësaj, është e papranueshme që të ketë ndryshime të mëdha të kushtetutës pa mos pasur edhe strategji përkatëse dhe qëllim të caktuar. Sipas kësaj, publiku jo vetëm që nuk është i njohur me qëllimet e ndryshimeve të Kushtetutës, por nuk është njoftuar as mbi pasojat dhe ndikimet që këto ndryshime do të kenë mbi jetën shoqërore. Dhe për më tepër, arsyetimet e shkurta dhe pa bazë të Propozim amendamenteve tregojnë mbi qasjen e papërgjegjshme të Qeverisë në krijimin e akteve më të rëndësishme ligjore.

Duke pasur këtë parasysh, **kërkuam nga Qeveria të tërheq Propozim amendamentet.** Kushtetuta e RM duhet të mbetet akt që garanton liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe që vendos themelet e funksionimit të shtetit, dhe jo akt që shkatërron sovranitetin e shtetit dhe që paraqet qëndrimet ideologjike të partisë aktuale në pushtet.

ORGANIZATAT KANË BAZUAR KËRKESËN E TYRE PËR TËRHEQJE TË PROPOZIM AMENDAMENTET EDHE PËR SHKAK TË KËTYRE MANGËSIVE THELBËSORE:

Amendamenti XXXIII definon bashkësinë mes një burrë dhe një grua si formë e vetme e bashkësisë jetësore që prodhon veprim ligjësor, me çarë çrregullohet e drejta për jetë familjare, parimi i drejtësisë dhe barazisë për të gjithë qytetarët. Ky amendament është në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejta të njeriut.

Amendamenti XXXIV përcakton rregulla të posaçme që do të vlejnjë vetëm për përdoruesit e zonave financiare ndërkombëtare, i shkyç rregullat e vendit, krijon dy sisteme paralele në një shtet dhe është në kundërshtim me politikën për konkurrencë të BE.

Me Amendamentin XXXVI Enti shtetëror për revizion fiton cilësinë e organit shtetëror me pozitë kushtetuese, kurse të gjitha organet shtetërore tjera të pavarura mbeten pa tipare direkte në kategorinë kushtetuese.

Rregullat fiskale të përcaktuara me **Amendamentin XXXVII** janë populistike dhe të panevojshme pasi që nuk parashohin masa dhe dënime

qo duhet zbatuar nëse shteti tejkalon deficitin prej 3% të BPV, dhe borxhin publik prej 60% të BPV.

Amendamenti XXXVIII nuk parasheh asnjë kusht shtesë mbi përvojën e 5 anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga profesorët universitar të drejtësisë, avokatët dhe juristët tjerë të dalluar. Veç kësaj, në momentin nuk duhet të miratohet vendim me të cilin Gjykata Kushtetuese do të vendos mbi ankesat kundër Këshillit Gjyqësor, pasi që Gjyqi nuk ka prestigj shoqëror sa i përket kompetencës ose pavarësisë së tij.

Amendamenti XXXIX parasheh ankesën kushtetuese pa mos siguruar kapacitetet resurset brenda Gjyqit Kushtetues për mbrojtje efikase të të drejtave të njeriut. Veç kësaj, amendamenti i përjashton nga mbrojtja kushtetuese të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe me këtë Maqedonia mbetet shtet social vetëm në aspektin deklarativ.

1 Në pajtim me konkluzionet e Kuvendit të RM prej 27 gusht 2014, Gazeta Zyrtare numër 28/2014.

2 Video incizimi i plotë i diskutimit publik është në dispozicion në: <http://bit.ly/alarm17>

